




Con il patrocinio di
**REGIONE
TOSCANA**



Udhëzues

Luaj me mua!

Aktivitete që këshillohen për të nxitur zhvillimin e aftësive praktike



Luajmë së bashku!

Të dashur prindër,

Ky libërth është krijuar me qëllimin që të ofrojë nxitje dhe ide për të luajtur me fëmijët tuaj në mënyrë të thjeshtë, krijuese dhe ekologjike.

Ide që nuk duhet të kthehen në ushtrime apo prova loje për t'u eksperimentuar nga fëmijët tuaj si në shkollë ose në terapi, por përvoja të pëlqyeshme shkëmbimesh, zbulimesh dhe fitimi aftësish.

Ide për të ndërtuar së bashku të cilat mund të jenë nxitje për ato pasdite që mund të kalohen në shoqëri, që ndihmojnë për të evituar ekspozimin e zgjatur ndaj televizorit dhe që përforcojnë vetëvlerësimin dhe ndjesinë e efikasitetit personal.

Rëndësia e lojës

*Lojërat e fëmijëve nuk janë lojëra dhe duhen
konsideruar si veprimet e tyre më serioze*

Michel de Montaigne

Përmes lojës

fëmija zbulon dhe eksperimenton:

- trupin e tij
- marrëdhëniet me tjetrin dhe me objektet
- Ambientin rrotull Në këtë mënyrë fiton kompetenca të rëndësishme ndaj një zhvillimi harmonik (emocional-relacional, konjitiv, gjuhësor, motorik-praktik)

Futuni në lojë

Kur luani me fëmijën tuaj:

- pozicionohuni në lartësinë e tij
 - kërkoni vështrimin e tij
 - vëzhgoni çfarë bën
- jepini kohën që i duhet për të eksperimentuar
- ofrojini mundësinë t'ju imitojë sintonizohuni me emocionet e tij dhe...

Argëtohuni

Fëmijët duhet të eksplorojnë dhe njohin me të gjitha shqisat

Për këtë arsye në dy vitet e para të jetës është e rëndësishme që t'u ofrohen dhe ndahen me ta objekte reale

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka publikuar disa rekomandime: të sapolindurit dhe fëmijët NUK duhen lejuar që pasivisht të shohin televizorin, smartfonin, tabletin ose kompjuterin. Udhëzimet e reja përcaktojnë se PARA MOSHËS DYMJEÇARE fëmijët NUK duhet asnjëherë të kalojnë kohë të ulur pasivisht përpara një ekrani.. Kufiri për fëmijët nga 2 deri 4 vjeç është një orë në ditë, por në përgjithësi do të ishte më mirë edhe më pak kohë.

Interneti dhe teknologjitë

Po, por...

si burim idesh dhe nxitjeje për të ndërtuar materiale të reja lojërash për fëmijën tënd



Shporta e thesareve

Duke filluar nga 6 muaj



Është një aktivitet që propozohet për fëmijët mbi 6 muaj, ose duke filluar nga momenti që qëndrojnë ulur vetë dhe kur interesi i tyre për botën që i rrethon rritet ndjeshëm. Një përvojë unike falë së cilës ata mund të zbulojnë dhe eksplorojnë botën përmes shqisave. Përmes përdorimit të duarve fëmijët mund të zbulojnë shumë rreth një objekti të caktuar, si peshën, përmasat, formën, zhurmën... Nëse organizohet mirë, shporta e thesareve mund të bëhet një rast për të zbuluar përmes përqendrimit dhe koordinimit sy-dorë.

Çfarë mund të fusni brenda një shporte thesaresh

- OBJEKTE ME ORIGJINË NATYRORE: boçe pishe, guaska, gështenja, gurë zalli, sfungjer natyror, lëvore arrash kokosi;
- OBJEKTE ME MATERIALE NATYRORE: lëmshe leshi dhe pambuku, kashtore për tenxheret, furça rroje, furçë dhëmbësh, krehra druri, furça me fije natyrale;
- OBJEKTE DRURI: raketake, kapëse rrobash, unaza perdes, lugë, mbajtëse vezësh;
- OBJEKTE METALI: tufa me çelësa, zinxhirë, rrahëse kuzhine, tiganë, kuti purosh, kapakë kavanozash, grirëse të vogla, forma biskotash, tapë vaske me zinxhir;
- OBJEKTE TË BUTA: lëkure, robe, gome, pelushi: penel për makijazh, copa tubi prej gome, top tenisi, çanta dore lëkure me zinxhir, paketa pëlhure me aromë livandoje, trumzë, karafil, lugë këpucësh prej bri.

Shporta e thesareve



Disa shembuj

- PËR INTEGRIMIN VIZUAL/DËGJIMOR/PREKËS: zile, tufa çelësash, qese me flluska ajri, fletë alumini...
- PËR INTEGRIMIN VIZUAL/PREKËS: plush, letër smerile, lojëra prej gome, rërë, fara bishtajore, miell të ndryshëm, makarona të pagatuara, shukumë rroje...
- PËR INTEGRIMIN PREKËS/SHIJUES/NUHATËS: Për integrimin prekës/shijues/nuhatës: pana, karota, brumë me kripë...

Po nëse fëmija i fut në gojë?

Për një fëmijë të vogël eksplorimi me gojë i objekteve është diçka normale, është mënyra e parë për të njohur botën (gjithmonë nën monitorimin e kujdesshëm të një të rrituri).

Kapja me pincetë

Jepini fëmijës mundësinë të kapë me pincetë objekte të vogla që përtypen, për shembull: topta drithërash ose copëza biskotash

Duke filluar nga 9 muaj



Për të përforcuar kapjen me pincetë:



Kapni copëza plastike me pincetë



Krijoni korniza me kapëse rrobash mbi kavanoza plastike

Fusni vezë plastike

Fusni vezë plastike në një enë në kapakun e së cilës është hapur një vrimë

Duke filluar nga 10 muaj



Objekte të përditshme për përdorimin e duarve

Duke filluar nga 18 muaj



Hapni dhe mbyllni ngjitëset Velcro të këpucëve

Duke filluar nga 20 muaj




Hapni dhe mbyllni një zinxhir (portofoli, xhupi, çante etj.)

Duke filluar nga 24 muaj



Filetoni dhe shfiletoni kapakun e një shisheje

Varësja



Duke filluar nga 24 muaj

Krijoni një varëse me makarona (për shembull gjysmë tuba) dhe një fill të fortë (për shembull spango kuzhine të lyer me vinovil dhe e lënë të thahet) ose një lidhëse këpucësh

Varësja me makarona dhe kopsa

Duke filluar nga 24 muaj



Shkoni në fill kopsa ose makarona gjithnjë e më të vogla, në një lidhëse këpucësh ose një spango kuzhine

Loja e “futjes”



Fusni kapakë stilolapsi në të çarën korresponduese të një kavanozi



Fusni disketa në të çarën korresponduese

Fusni tapa në të çarën korresponduese



Fusni rruaza brenda shkopinje të drurit të bllokuar në një top brumë modelues/brumë me kripë

Duke filluar nga 24 muaj



Fusni bastunë të vegjël në të çarën korresponduese

Lojërat me përshtatje formash dhe figurash

Duke filluar nga 24 muaj




Brumë modelues



Modeloni materiale të tjera lehtësisht të modelueshme ose brumë buke

Disa ide me gërshërët


36 muaj



Pritini zbulurimet prej letre sipas vijës

Duke filluar nga

Modeloni brumë modelues ose brumë buke për të krijuar “gjarpërinj” ose pritni materialin e modelueshëm me gërshërë me majë të rrumbullakët për të formuar “gnocchi” ose “karamelë” për të ushqyer kukullën






Pineskat

Jepini mundësi fëmijës të fusë pineskat në tavolinën e vogël në mënyrë të çrregullt (ose në rresht) ose duke ndjekur një model

Duke filluar nga 24 muaj



Itinerari



Përgatitsni në një fletë një rrugë, shtyni me një gisht një top/zar qelqi derisa të arrijë në fund

Bulonat

Duke filluar nga 36 muaj



Loja me marioneta



Luani me kukulla gishti të cilat duhet:

- të përshëndesin me një puthje (bashkoni gishtin e madh me gishtat e tjerë)
- të transportojnë objekte të vogla së bashku (bashkoni gishtin e madh me gishtat e tjerë)
- të përkulen (palosni çdo gisht)
- të zgjohen (nga grushti i mbyllur shtrini secilin gisht)
- t'i bëjnë këto veprime me secilën dorë dhe pastaj me të dyja duart njëkohësisht

Loja e përshkruar më lart mund të bëhet duke përdorur në vend të dorashkave letra ngjitëse me figura ose personazhe të ngjitura në secilën mollëz gishti, ose duke vizatuar me stilolaps fytyra në mollëzat e gishtave



Përvoja sensore-motorike ndihmon dhe lehtëson organizimin e veprimeve gjithnjë e më komplekse dhe qëllimore (aktivitetet) që i lejojnë fëmijës që: të vishet/të zhvishet, të hajë dhe të pijë vetë, të lahet, të vizatojë dhe shkruajë, të organizojë çantën e shpinës... TË JETË I PAVARUR

Shfrytëzoni pasionet tuaja

Mund t'i përfshini fëmijët tuaj në aktivitete të thjeshta të jetës së përditshme, me dëshirën e tyre për t'ju ndihmuar dhe mund të zhvillojnë aftësi të reja duke ndier kënaqësi.

Në kuzhinë

të bëjnë brumë



të trazojnë



të qërojnë bishtaja



të përgatisin tavolinën



Në kopsht

të gërmojnë



të ujin



të mbledhin lule dhe gjethe




Në shtëpi

- të rregullojnë sendet (të filetojnë/shfiletojnë)
- të ndejnë rrobat (me kapëse rrobash)
- të vënë objekte në vend (p.sh. të zbrazin qesen e pazarit ose lavastoviljen)
- të ngjisin objektet e thyera



Duke filluar nga 36 muaj

Eksperimentojmë edhe gjëra që mund të jenë të rrezikshme duke luajtur “me gjoja” (të qepin, të ngulin gozhdë me çekiç, të sharrojnë...)



Lojë me birila



Luani me një top që e lëshoni me dy duar (deri në 3 vjeç) ose me një dorë (duke filluar nga 4 vjeç) në drejtim të birilave për të rrëzuar sa më shumë prej tyre. Birilat mund të zëvendësohen me shishe plastike të mbushura me ujë sipas vështirësisë



Lojëra me hedhje dhe pritje


Duke filluar nga 4 vjeç



Luani me një top dhe një shishe duke e hedhur dhe duke e marrë



Luani duke hedhur shigjeta ose topa duke synuar të godisni qendrën e tabelës për të lehtësuar marrjen në shënjestër



luani tenis: me një top të vogël në fillim dhe një top më të madh më vonë për të lehtësuar marrjen në shënjestër



Mbështillni copa letre (alumini ose kartëpecete) për të formuar topttha ose hidhini topthat e formuar për të bërë kosh në kovë

Lojëra me përshtatje dy nga dy formash dhe figurash dhe herë pas here më komplekse deri te realizimi i pazëllit

Duke filluar nga 24 muaj



Memorizim figurash



Luani duke gjetur figurën e njëjtë ose duke mbushur kuadratet me figurën korresponduese; kjo lojë mund të bëhet vetëm, me dy persona ose në grup të vogël. Figurat mund të bëhen në karton, me foto ose vizatime të printuara



Gjeni ku vendoset dhe si vendoset


Duke filluar nga 24 muaj

Fëmija duhet të vendosë në vend topin në ngjyrën korresponduese




Duke filluar nga 4 vjeç

Vendosni në vend bastunët e vegjël me ngjyra në formën me ngjyrën korresponduese duke respektuar pozicionin



Duke filluar nga 4 vjeç

Me kubat me ngjyra ndërtoni kala, trena, shkallë dhe konfigurime të ndryshme, duke filluar nga ato më të thjeshtat deri tek ato më të komplikuarat (në strukturë dhe numër elementesh) formoni me një kub njëkohësisht ose jepini modelin më parë konkret dhe më pas të vizatuar



Kala me kuba

Duke filluar nga 20 muaj




Krijoni me kuba një
kala ose një tren


Aktivite ndërtuese me bastunë të vegjël

Duke filluar nga 4 vjeç


Për të kopjuar figurat gjeometrike mund të përdoren:




bastunët e vegjël



pipat




shkopinj druri



shkrepëse

Tangram

Duke filluar nga 4 vjeç



Me format gjeometrike mund të krijohen figura

Duke filluar nga 5 vjeç



Me shtatë tavolina të vogla me forma të ndryshme mund të krijohet një figurë duke përdorur të gjitha pjesët. Mund të filloni duke mbivendosur pjesët e ndryshme dhe më pas duke krijuar. Për të krijuar 7 format mund të kërkoni në internet “Tangram da colorare” (Tangram për ngjyrosje) për të gjetur fotografi dhe forma nga të cilat mund të merrni ide.

Vizatim me miell misri



Duke filluar nga 4 vjeç



Sipërfaqe vertikale

Përdorni dërrasa
(të zeza ose të
bardha), letra
ambalazhi të
varura në mur
Kopjoni gjurmë
vertikale dhe
horizontale,
rrathë, kryqe,
shtëpi, gjarpërinj,
re etj.



Shablone



Nën kujdesin e

Terapistëve të Aktiviteteve Neuro dhe Psiko-motorike të Moshës në Zhvillim) i Shërbimit Mjekësor të Rajonit të Toskanës

Me kontributin e Urdhrit të TSRM PSTRP në :

- Firenze, Arezzo, Prato, Pistoia, Lucca dhe Massa Carrara
- Pisa, Livorno, Grosseto
- Siena

Imazhet nga

Caterina Fineschi

TPX 5195 AUSL TC GRAFICA - LM



Këto sugjerime janë fryt i përvojës së punës nga një grup me TNPEE (Terapistë të Aktiviteteve Neuro dhe Psiko-motorike të Moshës në Zhvillim) i Shërbimit Mjekësor të Rajonit të Toskanës.

Puna e TNPEE ka si objektiv kryesor nxitjen e një zhvillimi të ekuilibruar dhe harmonik të fëmija në tërësinë e vet.

Terapisti i Aktiviteteve Neuro dhe Psiko-Motorike të Moshës në Zhvillim (TNPEE) bashkëpunon me ekipe multidisiplinore të formuara nga punonjës shëndetësie të rehabilitimit, të neuropsikiatrisë pediatrike, nga psikologu dhe profesionistë në fushën e rehabilitimit pediatrik dhe pedagogjik.

Për informacione dhe këshilla kontaktoni me Terapistin e Aktiviteteve Neuro dhe Psiko-Motorike të Moshës në Zhvillim pranë Shërbimit të Rehabilitimit Funkcional Pediatrik dhe Adoleshent në zonën tuaj.

Falënderojmë të gjithë fëmijët që morën pjesë në realizimin e këtij udhëzuesi

KËSHILLA BIBLIOGRAFIKE

“GIOCO, creo e imparo”, v. Santi, Astro Editore, 2019

“I giochi più stimolanti e creativi da fare con il tuo bambino da 0 a 6” G. Cozza, Newton Compton Editore, 2018

“Il gioco dei bambini”, E. Baumgartner, Carocci Editore, Collana Le Bussole, 2010

“Guidelines on physical activity, sedentary behaviour and sleep for children under 5 years of age” – World Health Organization, 2019

Testi sulle attività di Montessori da 0 mesi fino ai 6 anni

KËSHILLA PËR TË NAVIGUAR NË INTERNET

laminifactory.com/2018/09/5-cestini-dei-tesori-per-bambini-dai-6.html

Social Network Pinterest (duke kërkuar për shembull “giochi motricità fine” (lojëra për aftësi motorike të imëta) ose “attività grafomotorie” (aktivitete grafo-motorike) Nuvoleinscatola.it

Passettidalumaca.com